


TaxNews

Prill 2018
April 2018



Deloitte.

I. Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 953/2014 "Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar"

Këshilli i Ministrave ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime në VKM "Për dispozitat zbatuese të Ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" me anë të VKM nr. 2012 datë 20.04.2018, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 60, datë 27.04.2018, në fuqi prej datës 28.04.2018.

Ndryshimet dhe shtesa që kjo VKM bën janë përmbledhur më poshtë:

Afatet për dorëzimin e deklaratës së TVSH dhe të librave të shitjes dhe blerjes për tatimpaguesit me qarkullim nga 2 në 5 milionë Lekë

Në zbatim të nenit 107 "Afati i paraqitjes së deklaratës dhe periudha tatimore" të Ligjit "Për TVSH" Këshilli i Ministrave ka përcaktuar se:

- Afati për dorëzimin e deklaratës së TVSH për tatimpaguesit me qarkullim nga 2 në 5 milionë Lekë është data 14 e muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik, pra 14 prill, 14 korrik, 14 tetor dhe 14 janar;
- Afati për dorëzimin e librit të shitjeve dhe blerjeve për tatimpaguesit me qarkullim nga 2 në 5 milionë Lekë është data 10 e muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik, pra 10 prill, 10 korrik, 10 tetor dhe 10 janar;

I. Decision of Council of Ministers "On some additions and amendments to the DCM No. 953/2014 "On implementing provisions of the Law No. 92/2014 "On Value Added Tax"

The Council of Ministers has approved some additions and amendments to the DCM "On implementing provisions of the Law "On Value Added Tax in the Republic of Albania", through the DCM No. 212 dated 20.04.2018, published in the Official Gazette No. 60, dated 27.04.2018, in force as of 28.04.2018.

We have summarized below the amendments and additions made by this DCM:

Deadlines for the submission of VAT return and sales and purchases books of taxable persons with an annual turnover from ALL 2 to 5 million

Pursuant to article 107 "Deadline for the submission of VAT return and VAT tax period" of the Law "On VAT", the Council of Ministers determines that:

- The deadline for submission of the VAT return for taxable persons with an annual turnover from ALL 2 to 5 million is the 14th of the first month that follows the end of each quarter of the calendar year, namely 14 April, 14 July, 14 October and 14 January;
- The deadline for submission of the sales and purchases books for taxable persons with an annual turnover from ALL 2 to 5 million is the 10th of the first month that follows the end of each quarter of the calendar year, i.e. 10 April, 10 July, 10 October and 10 January;

- Afati i dorëzimit të deklaratës së TVSH dhe të librave të shitjeve dhe blerjeve nuk ndryshon për kategorinë e tatimpaguesve të cilët janë subjekt i TVSH pavarësisht qarkullimit (pra, ata që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike sipas profesioneve të tilla si avokat, mjek i specializuar, inxhinier, ekonomist etj.).

Kufiri i regjistrimit për TVSH për prodhuesit bujqësorë dhe kategoritë e tyre

Në zbatim të 117 "Objekti i regjimit të bizneseve të vogla" të Ligjit "Për TVSH", VKM ka përcaktuar kufi të ndryshëm të regjistrimit për TVSH për kategoritë e mëposhtme të prodhuesve bujqësorë:

- Për prodhuesit bujqësorë të cilët zbatojnë regjimin e veçantë të skemës së kompensimit dhe që zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike si fermerë individualë, kufiri i regjistrimit për TVSH është qarkullimi vjetor prej 5 milion lekë;
- Për prodhuesit bujqësorë të cilët zbatojnë regjimin e veçantë të skemës së kompensimit dhe që zhvillojnë veprimtarinë ekonomike në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore të organizuar si shoqëri e bashkëpunimit bujqësor nuk zbatohet limiti i regjistrimit prej 5 milionë Lekë por limiti i përgjithshëm prej 2 milionë Lekë nëse kryejnë edhe veprimtari të tjera përveç shitjeve në kuadrin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të fermerëve.

- The deadline for submission of the VAT return and sales and purchases books does not change for the category of taxable persons that are subject to VAT regardless of turnover (i.e. those who provide services in economic activities of certain professions such as lawyer, specialist doctor, engineer, economist, etc.).

VAT registration threshold of agricultural producers and their categories

Pursuant to article 117 "Scope of small enterprises regime" of the Law "On VAT", the DCM has determined different VAT registration thresholds for the following categories of agricultural producers:

- For agricultural producers that apply the special compensation regime and perform their economic activity as individual farmers the VAT registration threshold is the annual turnover of ALL 5 million;
- The VAT registration threshold of ALL 5 million does not apply on agricultural producers that apply the special compensation regime and perform their economic activity under an agricultural undertaking organized as an agricultural cooperative. However, the general VAT registration threshold of ALL 2 million would apply if they perform other economic activities in addition to sales under the special compensation regime of farmers.

Përfshihen nga TVSH në import makineritë dhe pajisjet e lidhura me prodhimin e energjisë së rinovueshme

Në zbatim të gërme c) të pikës 38 të nenit 56 "Përfshime të veçanta në import" të Ligjit "Për TVSH", Këshilli i Ministrave ka miratuar listën e makinerive dhe pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë Lekë për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar prodhimi mbi 0.5 Mw (më parë këto makineri dhe pajisje nuk ishin të përfshiuara nga TVSH).

The exemption from VAT of the machineries and equipment related to renewable energy production

For the implementation of letter c) of paragraph 38 of article 56 "Special exemptions on import" of the Law "On VAT" the Council of Ministers has approved the list of machineries and equipment directly related with the realization of investment contracts of a value equal to or higher than ALL 50 million on the production of renewable solar energy with installed production capacity of over 0.5 Mw (previously, such machineries and equipment were not exempt from VAT).

II. Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për Organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë"

Me anë të Vendimit nr. 171, datë 28.03.2018, Këshilli i Ministrave ka miratuar rregullat për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë. Lutemi referojuni edicionit special të Legal News publikuar gjatë muajit prill për më shumë informacione.

II. Decision of Council of Ministers "On the organization and functioning of the General Directorate of Property Tax"

Through the DCM no. 171, dated 28.03.2018, the Council of Ministers has approved respective rules for the organization and functioning of the General Directorate of Property Tax. For more information, please refer to the special edition of the Legal News published during the month of April.

III. Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për mbrojtjen shoqërore

Marrëveshja midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për mbrojtjen shoqërore u ratifikua me anë të Ligjit nr. 14/2018, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 51, datë 12.04.2018. Kjo marrëveshje parashikon rregullat për koordinimin e zbatimit të legjislativioneve përkatëse të të dy vendeve lidhur me sigurimet shoqërore. Kjo marrëveshje pritet të sjellë përfitim për punonjësit shqiptarë që punojnë në Austri (dhe anasjelltas), për të cilët do të merren në konsideratë periudhat e sigurimit gjatë kohës që punojnë në shtetin tjetër në rastin kur përllogaritet e drejta për përfitime (p.sh. pension).

III. The ratification of the Agreement on social protection between the Republic of Albania and the Republic of Austria

The agreement between the Republic of Albania and the Republic of Austria on social protection was ratified by Law no. 14/2018, published in the Official Gazette no. 51, dated 12.04.2018. This agreement includes rules that coordinate the implementation of respective legislative provisions of both countries on social security. This agreement is expected to have a beneficial impact on Albanian employees working in Austria (and vice-versa) whose periods of insurance while in Austria will be taken into account in the calculation of their entitlement to benefits (e.g. pension).

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.